




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
KORÇË



Korçë, me 25.10.2023

**SHPLLJE VENDIMI**

**Drejtur : Bashkise Maliq**

Për: Florie Ymeraj  
Me adrese: Libonik Bashkia Maliq

Bashkalidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 741 dt. 29.09.2023 për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : " Larguar ..." dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

**KANCELARE**  
**Geralda Kasuli**



U afishua sot ne datë -----  
Per Bashkine Maliq

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, firmë)

Mr. 159 Prot  
dt. 1.11.2023

- Kuj. A. Gjonish  
- STAMP  
dt 30.10.2023 ✓  
Gjonish

Gjykata duke mbajtur parasysh parashikimin e nenit 18 pika 1, germa "b" te ligjit, caktoi seancen gjyqesore brenda 48 oreve nga parashtimi i kerkeses (meqenese paditesja rezulton madhore). Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ka kompetencen lendore dhe tokesore per te shqyrtuar padine, pasi eshte gjykata e vendbanimit te viktimes dhe te dhunuesit, ne perputhje me nenin 9 dhe nenin 12 pika 1 te ligjit nr.9669, date 18.12.2006, i ndryshuar.

Paditesja legjitimohet ne berjen e kesaj kerkese padie ne baze te nenit 4, nenit 3 pika 3 dhe nenit 13 pika 3 germa "a" te ligjit, pasi ajo eshte nje prej subjekteve qe mbrohet nga ligji nr. 9669 date 18.12.2006, i ndryshuar, perkatesisht si bashkeshortja e dhunuesit te pretenduar.

Padia e saj eshte drejtuar ndaj personit qe ajo pretendon se e ka dhunuar, qe eshte bashkeshorti i saj, ne baze te nenit 3/5 te ligjit te posaçëm, ndaj per rrjedhim i padituri gezon legjitimitet pasiv dhe nese pretendimet e pales paditese rezultojne te bazuara, mbi palen e paditur rendon detyrimi te zbatoje masat mbrojtese te vendosura me leshimin e urdherit te menjehershem te mbrojtjes.

Paditesja Florie Ymeraj eshte paraqitur ne Komisariatin e Policise Maliq dhe ka bere kete deklarim: *Jam me banim ne fshatin Çekavesh, Njesia Administrative Tregan, Elbasan. Jam paraqitur ne ambjentet e Komisarariatit te Policise Maliq dhe deklaroj se sot ne date 26.09.2023, rreth ores 08:00 une se bashku me te dy femijet e mij te mitur, te quajtur Jurgen Ymeraj i moshes 5 vjeç dhe Eljon Ymeraj i moshes 3 vjeç. jam larguar nga banesa e bashkeshortit tim te quajtur Kujtim Ymeraj dhe se bashku me femijet e mi kam ardhur ne Maliq rreth ores 11:30 te dites se sotme. Deklaroj se une kam ikur vete me deshiren time nga banesa e bashkeshortit tim Kujtim Ymeraj pasi une nuk dua te jetoj më me këtë person. Une kam vendosur te divorcohem me bashkeshortin tim Kujtim Ymeraj pasi une kam krijuar nje lidhje te re me te dashurin tim te quajtur Olsjan Lazi, i cili banon ne qytetin e Maliqit dhe konkretisht ne Libonik, ne adresen lagjia "Xhamia e vogel" banese private pa numer, Libonik, Maliq, Korçë. Deklaroj se une do te jetoj se bashku me te dy femijet e mi ne banesen e te dashurit tim Olsjan Lazi me te cilin do te bashkejetoj dhe nderkohe une do te vazhdoj procesin e divorcit me ish bashkeshortin tim shtetasin Kujtim Ymeraj. Gjithashtu deklaroj se te dy femijet e mi do t'i mbaj une deri ne momentin qe do te shprehet Gjykata me vendim gjyqesor konkret per dhenien e se drejtes se prinderimit te dy femijeve. Gjithashtu une deklaroj se nuk do ta pengoj ne asnje moment ish bashkeshortin tim Kujtim Ymeraj qe ky person te shohe dhe te takoje sa here te doje te dy femijet tane te quajtur Jurgen Ymeraj i moshes 5 vjeç dhe Eljon Ymeraj i moshes 3 vjeç. Deklaroj se te dy femijet e mi jane me shendet te plote dhe aktualisht jane ne banesen e te dashurit tim, ne banesen e shtetasit Olsjan Lazi nen kujdesin e mamase se tij, shtetases Marjeta Lazi dhe motres se tij Marinela Lazi. Une kam te ardhurat e mija dhe deklaroj se te dy femijet e mi do t'i mbaj dhe do t'i trajtoj ne menyren me te mire te mundshme, pasi per rritjen e te dy femijeve te mi, une kam mbeshetjen financiare edhe te te dashurit tim shtetasit Olsjan Lazi dhe te mamase se tij shtetases Marjeta Lazi. Une deklaroj se nuk do te kthehem me asnjehere ne banesen e ish bashkeshortit tim shtetasit Kujtim Lazi. Une kerkoj te pajisem me urdher mbrojtje ndaj ish bashkeshortit tim Kujtim Ymeraj pasi une ndjehem e frikesuar dhe e kercenuar nga ky person i cili mund te vije ne Maliq per te me bere keq dhe per te me demtuar fizikisht dhe nga kjo arsye une kerkoj pajisjen me urdher te menjehershem mbrojtje.*

Pas marrjes se kesaj deklarate nga paditesja dhe vleresimit te situates, Shefi i Komisarariatit te Policise Maliq ka nxjerre urdherin nr.2462/2, date 27.09.2023, me te cilin ka urdheruar:

*"Marrjen e masave paraprake te mbrojtjes se menjehershme:*

- a) *Urdherimi i dhunuesit qe te mos kryeje ose te mos kercenoje se do te kryeje veprime te metejshme te dhunes ne familje ndaj viktimës.*

- b) *Urdherimi i dhunuesit qe te mos cenoje, ngacmoje, kontaktoje ose komunikojë drejtperdrejt ose terthorazi me viktimën.*
- c) *Ndalimi menjehere i dhunuesit qe t'i afrohet strehes, vendit te punes, baneses se viktimes dhe vendeve qe frekuentohen me se shumti prej viktimes, me perjashtim te rastit kur frekuentimi behet per arsye pune.*

Ne seancen e sotme gjyqesore te caktuar per te shqyrtuar kerkesen per leshim te urdherit te menjehershëm te mbrojtjes, u paraqiten te dy palet.

Paditesja Florie Ymeraj ka deklaruar se me te paditurin Kujtim Ymeraj jane te martuar prej 11 vitesh dhe kane dy femije. Me bashkeshortin nuk kane shkuar mire, ka vendosur te ike dhe te shkoje tek personi qe ajo do, i cili quhet Olsi dhe jeton ne Libonik, me te cilin ka rreth 3 vjjet e gjysem qe njihet. Ka 4 dite qe ka ikur duke marre dhe femijet me vete. Bashkeshortit nu ki ka treguar qe ka ikur, i ka thene vetem mamase se saj. Ka shkuar ne polici pasi kishte frike se mos bashkeshorti i bente ndonje gjë per femijet, per shkak te veprimit qe beri, pra qe mori femijet dhe iku. Ai nuk ka bere asgje, por i shkon mendja per çdo gje te keqe. Kerkon qe i padituri ta lere te qete, femijet t'i takojë sa here te doje, nuk i ndalon, mos i kercenoje, mos iu dergoje njerez ne shtepia, te mos i afrohet shtepise se bashkejetesuesit, Olsit.

Kurse i padituri Kujtim Ymeraj deklaroi se si familje kane pasur probleme, kane veshtiresi ekonomike, jetojne me qira. Paditesja qe pas lindjes se femijes se pare ka ndryshuar dhe nuk shkojne aq mire sa ne fillim, por nuk eshte e vertete ajo qe thote se ka tre vite e lidhur me kete person, mund te kete vetem disa jave. Ai e ka pare teksa komunikonte ne telefon dhe i ka kerkuar llogari se me ke fliste, por ajo e genjente dhe ja fshinte telefonin. Per kete gje qe ka bere mund te jete shtyre nga e ema ose nga i vellai, pasi para disa ditesh ka shkuar ne Tirane pa lejen e tij. Ne lidhje me largimin nga shtepia ai nuk dinte gje pasi ishte ne pune. Kur eshte kthyer nuk e ka gjetur ne shtepi, e ka marre ne telefon por i dilte i fikur, e ka kerkuar tek e ema e saj sepse atje rrinte pjesen me te madhe te kohes, por ajo i ka thene nuk e di ku eshte. E ka kerkuar ne Elbasan, eshte kthyer ne shtepi por ajo perseri nuk kishte ardhur. Pas kesaj e ka telefonuar i biri me telefonin e paditeses dhe i ka thene qe ishine ne Shkoder. Kur ka ardhur mbesa nga shkolla, i ka treguar se Floria ishte e lidhur me nje person dhe komunikonte me te me whatsapp.

Duke qene se nuk i dinte asnje adrese bashkeshortes dhe ajo kishte marre me vete edhe femijet, ka vajtur dhe ka bere denoncim ne policine e Elbasanit. Me pas e kane marre ne telefon nga Komisariati i Policise Maliq dhe i kane thene se Floria se bashku me femijet ishte ne Libonik. I padituri deklaroi gjithashtu se paditesja duhet te kete probleme mendore pasi veprime te tilla nuk i ben nje njeri normal. Ajo eshte kuruar prej nje viti pasi ankohej se i dhimbte koka e barku, ai i ka blere ilaçe dhe nuk i binte ne qafë per te mos e shqetesuar. I kerkon paditeses te kthehet ne shtepi dhe te mendoje per femijet dhe per veten e saj, ai ja ka falur per sa ka bere. Edhe ne rast se vendos qe te mos kthehet, deklaroi se nuk ka per t'i bere asgje, le te shohe punen e saj, ai kerkon vetem qe te takojë femijet dhe te kujdeset per ta.

Pas ketyre deklarimeve te te paditurit, paditesja u shpreh se urdherin e mbrojtjes e kishte kerkuar ngaqë ishte e frikesuar se mos i padituri bente ndonje veprim ndaj saj, por derisa ai deklaroi se nuk do beje asgje, nuk e kerkon më urdhërin e mbrojtjes. Per sa me siper, paditesja kerkoj te heqe dore nga kerkesa per leshim te urdherit te menjehershëm te mbrojtjes.

Ne nenin 13/1 te ligjit nr.9669, date 18.12.2006 "Per masa ndaj dhunes ne marrëdhëniet familjare" i ndryshuar, te titulluar *Urdhri per masat paraprake te mbrojtjes se menjehershme*, parashikohet:

1. *Kur nga kryerja e vleresimit te riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik per jeten, shendetin dhe lirine e anetareve te familjes, strukturat pergjegjese per trajtimin e rasteve te*

dhunes ne familje, prane Policise se Shtetit, marrin menjehere masa paraprake te mbrojtjes se viktimes/ave dhe per ndalimin e dhunes.

2. Ne urdhrin per masat paraprake te mbrojtjes se menjehershme, sipas pikes 1, te ketij neni, percaktohen nje ose disa nga masat e meposhtme:

a) urdherimi i dhunuesin/es qe te mos kryeje ose te mos kercenoje se do te kryeje veprime te metejshme te dhunes ne familje ndaj viktimes ose pjesetareve te tjere te familjes se viktimes;

b) urdherimi i dhunuesit/es qe te mos cenoje, ngacmoje, kontaktoje ose te komunikojte drejtperdrejt ose terthorazi me viktimen ose pjesetare te familjes se viktimes;

c) ndalimi menjehere i dhunuesin/es, qe t'i afrohet strehes, vendit te punes, baneses se familjes se origjines ose te baneses se personave te tjere dhe institucioneve arsimore, ose vendeve te cilat frekuentohen me teper nga viktimja, me perjashtim te rasteve kur frekuentimi behet per arsye pune;

ç) vendosja menjehere e viktimes ne nje qender rezidenciale ose emergjence per viktimat e dhunes ne familje deri ne marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdherimi i nje punonjesi te Policise se Shtetit, qe te shoqeroje viktimen ne qendren rezidenciale ose te emergjences, sipas shkronjes "ç", te kesaj pike;

dh) urdherimin e nje punonjesi te Policise se Shtetit qe te shoqeroje viktimen deri ne vendbanimin e tij/te saj dhe te mbikeqyre marrjen e sendeve personale;

e) bllokimi i çdo arme me leje qe i perket dhunuesit gjate kontrollit te kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje qe i perket atij, deri ne marrjen e vendimit nga gjykata.

3. Urdhri per masat paraprake te mbrojtjes se menjehershme nxirret nga titullari i struktures pergjegjese te Policise se Shtetit, ne juridiksionin e se ciles eshte raportuar dhuna sipas procedures dhe modelit, te percaktuar me udhezim te perbashket te ministrit pergjegjës per çeshtjet e rendit dhe sigurise publike dhe ministrit pergjegjës çeshtjet e barazise gjinore dhe luftes kunder dhunes ne familje. Nje kopje e urdhrin per masat paraprake te mbrojtjes se menjehershme i njoftohet menjehere koordinatorit vendor per referimin e rasteve te dhunes ne marredheniet familjare.

4. Ne rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose ne prani te femijeve, Policia e Shtetit merr menjehere ne mbrojtje femijen dhe njekohesisht referon rastin prane Njesise per Mbrojtjen e Femijeve ne njesine e veteqeverisjes vendore, sipas rregullave te parashikuara ne legjislacionin ne fuqi per te drejtat dhe mbrojtjen e femijes.

5. Brenda 48 oreve nga marrja e masave, sipas percaktimit te pikes 1, te ketij neni, organet pergjegjese per trajtimin e rasteve te dhunes ne familje, prane Policise se Shtetit, paraqesin perpara gjykates kerkese per vleresimin e masave paraprake te mbrojtjes se menjehershme dhe kerkesepadi per leshimin e urdhrin te menjehershem te mbrojtjes.

6. Te drejten per te kerkuar vleresimin e urdhrin per masat paraprake te mbrojtjes se menjehershme perpara gjykates e ka edhe viktimja dhe subjektet e parashikuara nga neni 13, pika 3, e ketij ligji, brenda 48 oreve, nga dita e leshimit te tij.

7. Gjkata, 48 ore nga dita e paraqitjes se kerkeses, ne seance gjyqesore vendos:

a) vleresimin e masave mbrojtese te vendosura ne urdhrin per masat paraprake te mbrojtjes se menjehershme dhe leshimin e urdhrin te menjehershem te mbrojtjes;

b) anulimin e urdhrin per masat paraprake te mbrojtjes se menjehershme dhe nderprerjen e pasojave te tij, nese nuk provohen faktet dhe rrethanat per te cilat eshte leshuar.

8. Gjkata, per nevoja te gjykimit, mund te therrase perfaqesuesin e Policise se Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor per referimin e rasteve te dhunes ne marredheniet familjare, te paraqiten ne seance gjyqesore per te dhene shpjegime".

Neni 19 pika 1 i ligjit nr.9669, date 18.12.2006 "Per masa ndaj dhunes ne marredheniet familjare" i ndryshuar parashikon kete rregullim: "Gjkata leshon me vendim urdherin e menjehershem te mbrojtjes duke caktuar nje ose me shume prej masave te percaktuara ne nenin 10 te ketij ligji, nese konstaton se:

- a) ekzistojnë baza për të besuar se i/e padituri/a (dhunuesi/ja) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë veprim të dhunës në familjes; ose
- b) i/e padituri/a (dhunuesi/ja) paraqet kërcënim të drejtperdrejtë dhe të menjehershëm për sigurinë dhe mirëqenien e viktimes dhe të anetareve të tjerë të familjes së viktimes; ose
- c) lëshimi i urdherit të menjehershëm të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur shëndetin ose mirëqenien e viktimes apo të anetareve të tjerë të familjes së viktimes, që mbrohen me anë të urdherit të mbrojtjes”.

**Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet dhe qëndrimin e palës paditëse dhe të paditurit që rezultonte nga aktet si dhe duke aplikuar rregullimet ligjore të sipërcituara, në rrethanat e faktit, çmon se në rastin konkret, ekzistojnë kushtet ligjore për vlerësimin e masave të mbrojtjes të vendosura në urdhërin nr.2462/2, datë 27.09.2023, si dhe ekzistojnë kushtet ligjore për pushimin e çështjes në lidhje me kërkesën për lëshim të urdherit të menjehershëm të mbrojtjes në favor të palës paditëse.**

Ne lidhje me urdherin për masat paraprake të mbrojtjes së menjehershme nr.2462/2, datë 27.09.2023, rezulton se është marrë nga organi kompetent, i autorizuar nga ligji (titullari i strukturaes përgjegjëse në Policinë e Shtetit, në juridiksionin e të cilit është raportuar dhuna), në urdherin përkatës janë caktuar si masa paraprake disa nga masat e parashikuara nga germa a)- dh), të pikës 2 të nenit 13/1 të ligjit të posaçëm, gjykata është investuar brenda afatit ligjor 48 orësh nga nxjerrja e urdherit dhe për më tepër urdheri është në themel i bazuar pasi referuar deklaratimeve të paditëses dhe dinamikes së ngjarës, është vlerësuar se i padituri paraqet rrezik për shëndetin e palës paditëse, patur parasysh se ajo ishte larguar nga banesa bashkeshortore së bashku me fëmijet për të shkuar tek një person me të cilin kishte lidhje jashtëmartesore.

Ne lidhje me urdherin e menjehershëm të mbrojtjes, gjykata çmon se duhet vendosur pushimi i gjykimit të çështjes pasi jemi në kushtet e nenit 201 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet “1.Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i paditëses. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes. 2.Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të paditurit nuk ka shkak të ligjshëm”.

Në këto rrethana, gjykata referuar kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, çmon se në këto rast duhet të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes për këtë shkak.

Në kushtet kur Gjykata vlerëson se gjykimi për lëshimin e urdherit të menjehershëm të mbrojtjes duhet pushuar, nuk mund të vazhdohet as me gjykimin e vertetimit të urdherit të mbrojtjes, për faktin se në atë gjykim mund të vendoset anulimi i masave, ndryshimi i tyre apo refuzimi i lëshimit të urdherit të mbrojtjes në rast se masat e caktuara nuk rezultojnë të bazuara, ashtu siç parashikon edhe neni 20 i ligjit të posaçëm, por gjithnjë në rast se gjykata ka disponuar me pare me vendim për lëshimin e urdherit të menjehershëm të mbrojtjes.

### **PËR KËTO ARSYE**


Gjykata bazuar në nenet 16 dhe 17 të ligjit nr 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, si dhe nenet 201/1 e 299/b të K.Pr.Civile

## VENDOSI

1. Vlerësimin e urdhërit nr.2462/2, datë 27.09.2023 të Shefit të Komisarariatit të Policisë Maliq “Për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nga dhuna në familje”.
2. Pushimin e gjyqimit për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që ju përket palëve paditëse Florije Ymeraj, i paditur Kujtim Ymeraj, për shkak të heqjes dorë të paditëses nga gjykimi.
3. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.
4. Një kopje e vendimit t’i njoftohet edhe Komisarariatit të Policisë Maliq.

U shpall në Korçë, në datë 29.09.2023 ora 11:07

SEKRETARE  
JANULLA TANKA



GJYQTARE  
LULJETA KOLE

